



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 400/01-25326 dt. 30/06/ 2026



Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40 të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale Nr.03/L-040, nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 53, 57 dhe 58 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 , 12.2 pika d) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit si dhe Shkresës së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Nr.DL-3254-2/26 të datës 16.06.2026. Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.06.2026 miratoi këtë:

V E N D I M

Për Shfuqizimin e vendimit 02 Nr.020/04-19807 të datës 29.05.2026 për themelimin e komisionit për verifikimin e lejeve ndërtimore nga viti 2017 e deri në vitin 2026

Neni 1

Bazuar në legjislacionin në fuqi si dhe Shkresës së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Nr. DL-3254-2/26 të datës 16.06.2026, Kuvendit të Komunës miraton që në procedurën e rishqyrtimit dhe rivendosjes të shfuqizoj vendimin 02 Nr.020/04-19807 për themelimin e komisionit për verifikimin e lejeve ndërtimore nga viti 2017 e deri në vitin 2026.

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi janë përgjegjëse Kuvendi Komunal dhe Zyra e Kryetarit.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Bujupi

ARSYETIM

Komuna e Drenasit në harmoni me legjislacionin në fuqi i cili e rregullon këtë fushë ka filluar procedurat për Themelimin e komisionit për verifikimin e lejeve ndërtimore nga viti 2017 e deri në vitin 2026, si rrjedhojë e të cilit proces është edhe miratimi i të njëjtit vendim. Kuvendi komunal me datë 29.05.2026 miraton vendimin për themelimin e komisionit në fjalë dhe i njëjti nga ana MAPL-së për tek Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për shqyrtimin e ligjshmërisë dorëzohet me datë 11.06.2026.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor përmes aktit të saj Nr. DL-3254-2/26 të datës 16.06.2026 konstaton se akti në fjalë është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si të tillë e kundërshton ecjen tutje të këtij projekt akti. Në arsyetimin e saj konstaton se vendimi 02 Nr.020/04-19807 për themelimin e komisionit për verifikimin e lejeve ndërtimore nga viti 2017 e deri në vitin 2026 nuk parashihet me Ligjin Nr.04/L-110 për ndërtimin.

Duke marrë parasysh një situatë të tillë Kryetari i Komunës përmes këtij propozim vendimi i propozon Kuvendit të Komunës që duke marrë parasysh legjislacionin në fuqi dhe konstatimet e bëra nga Ministria gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së këtij akti të votohet ky propozim vendim.